

# KOMUNIKATË PËR SHTYP

## MISION INSTITUCIONAL PËR PËRFORCIMIN E RAPORTEVE BILATERALE NDËRMJET ITALISË DHE SHQIPËRISË NË KUADRIN E MBROJTJES SË TRASHËGIMISË KULTURORE

**Milano, 18 Maj 2021**

Një mision i rëndësishëm institucional do të jetë i pranishëm nga data **24 deri 25 maj** me synim vazhdimsinë dhe **forcimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë** në nismat për mbrojtjen, ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore.

Ky event - i organizuar nga **Ambasada Italiane në Tiranë, Agjencia ICE, Assorestauro** dhe **Salloni ndërkombëtar i Restaurimit** së bashku me **Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministrija Elva Margariti**, ka në program një konferencë për shtyp për prezantimin e “Salloni i Restaurimit në tour” në Bari dhe “Restoration Week 2021” (Java e Restaurimit 2021).

**Konferenca e shtypit**, që do të zhvillohet me datë **24 maj në orën 11.00**, do të mund të ndiqet në dy gjuhë në live streaming në [www.restorationweek.it/albania2021](http://www.restorationweek.it/albania2021) si dhe në kanalet social të @salonedelrestauro (në gjuhën italiane) dhe @AmbasciataItaliaTirana (në gjuhën shqipe).

Ndërhyjnë:

Elva Margariti, Ministre e Kulturës së Republikës së Shqipërisë

Fabrizio Bucci, Ambasadori italian në Tiranë

Michele Emiliano, Presidenti i Rajonit të Puglia-s

Alessandro Bozzetti, Presidenti i Assorestauro

Andrea Moretti, Presidenti i Ferrara Fiere

Alessandro Ambrosi, Presidenti i Fiera del Levante

Elisa Scelsa, Drejtoreshë e Zyrës ICE Agjencia - Tirana

Andrea Griletto, Drejtor i Assotestauro

Do të organizohet gjithashtu një tavolinë teknike me përfaqësuesit institucional shqiptar dhe pjestarët e delegacionit. Ky event do të përmbyllet me një tour të vendeve me interes historik dhe arkitektonik në Shqipëri.

Ky bashkëpunim, tashmë i nisur do të intensifikohet më tej me dorëzimin e **ftesës zyrtare për Ministrinë e Kulturës e cila do të përfaqësojë Shqipërinë, si një vend i ftuar, në të dy edicionet e eventeve të parashikuara për këtë vit.**

**Salloni Ndërkombëtar i Restaurimit**, që do të zhvillohet pranë Panairit të Fiera del Levante në Bari nga data **1 deri me 3 shtator** dhe **Java e Restaurimit** një evet që do të mbahet në Napoli, Matera, Pompei dhe Bari nga data **30 gusht deri me 4 shtator**, prezantohen si dy momente të veçanta për takime e shkëmbime me institucionet shqiptare, me synimin për të forcuar raportet institucionale e tregtare ndërmjet dy vendeve. Ky edicion i Restoration Week si dhe ai i Sallonit të Restaurimit do të zhvillohen në formë hibride pra si me prezencë ashtu edhe online në faqet web [www.restorationweek.it](http://www.restorationweek.it) e [www.salonedelrestauro.it](http://www.salonedelrestauro.it).



Ministero degli Affari Esteri  
e della Cooperazione Internazionale



ITALIAN TRADE AGENCY  
ICE - Agenzia per la promozione all'estero e  
l'internazionalizzazione delle imprese italiane

assorestauro

associazione italiana per il restauro architettonico, artistico, urbano  
italian association for architecture, art and urban restoration

Restoration  
week



RESTAURO  
SALONE INTERNAZIONALE